

LIGJ
Nr. 56/2016

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 33/2014, “PËR MIRATIMIN E
HUAMARRJES PREJ 295 420 000 SDR-SH, QË FONDI MONETAR
NDËRKOMBËTAR I AKORDON SHQIPËRISË PËR PROGRAMIN 36-MUJOR TË
NDIHMËS (EFF)”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 156, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në aneksin nr.1, bashkëlidhur ligjit nr. 33/2014, “Për miratimin e huamarrjes prej 295 420 000 SDR-sh, që Fondi Monetar Ndërkombëtar i akordon Shqipërisë për programin 36-mujor të ndihmës (EFF)”, paragrafi i katërt ndryshohet si më poshtë:

“Komisioni i angazhimit aplikohet në çdo fillim periudhe 12-mujore, nga data e aprovimit të huas në bordin e FMN-së, mbi shumat që parashikohet të tërhiqen gjatë kësaj periudhe. Norma e këtij komisioni është 15 bp (0,15%) për shumat të angazhuara deri në vlerën 115% të kuotave të anëtarësisë së Shqipërisë në FMN (që janë 139,3 milionë SDR), 30 bp (0,3%) për shumat të angazhuara në vlerat 115% - 575% të kuotave, ndërsa për shumat të angazhuara që e kalojnë këtë vlerë, norma e komisionit rritet në 60 bp (0,6%).”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 2.6.2016

**Shpallur me dekretin nr. 9636, datë 14.6.2016 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

ANEKSI 1

Në aneksin 1 të ligjit nr. 33/2014, “Për miratimin e huamarrjes prej 295,420,000 SDR, që Fondi Monetar Ndërkombëtar i akordon Shqipërisë për programin 36-mujor të ndihmës (EFF)” në paragrafin e katërt të tij mbi “komisionin e angazhimit”, propozohet të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Komisioni i Angazhimit aplikohet në çdo fillim periudhe 12-mujore, nga data e aprovimit të huasë në Bordin e FMN-së, mbi shumat që parashikohet të tërhiqen gjatë kësaj periudhe. Norma e këtij komisioni është 15 bp (0.15%) për shumat të angazhuara që deri në 115% të kuotave të anëtarësisë së Shqipërisë në FMN (që janë 139.3 milionë SDR), 30 bp (0.3%) për shumat të angazhuara në vlerën 115%-575% të kuotave, ndërsa për shumat të angazhuara që e kalojnë këtë vlerë norma e komisionit rritet në 60 bp (0.6%).

Paragrafët e tjerë të aneksit 1 nuk ndryshojnë.